

MËSIMI I KOMBINUAR


Një zgjidhje efektive për të nxënit
në arsimin profesional

Raste të mira 2022



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Zbatuar nga:


swisscontact



Të dashur lexues,

Në fillim të vitit akademik 2019-2020, askush prej nesh nuk mund të imagjinonte se do të gjendeshim në kushtet e izolimit të plotë për shkak të një pandemie globale, ku mësimi online ishte e vetmja mundësi për të zhvilluar procesin mësimor. Në arsimin profesional, të gjithë aktorëve iu desh të përballëshin me sfida të shumta dhe të përpiqeshin për t'u adaptuar me shpejtësi asaj që nga të gjithë u pranua si "normalja e re". Pavarësisht vështirësive dhe sfidave, sistemi arsimor në tërësi dhe ai profesional në veçanti pati edhe një sërë përfitimesh falë orientimit drejt metodave bashkëkohore mësimore, mbështetur në dimensionin virtual të të nxënit. Të gjithë punuam së bashku për të shndërruar krizën në revolucion, duke sjellë risi në mësimdhënie dhe në të nxënë.

Sot, pas një pune intensive dy-vjeçare, jemi dëshmitarë të modernizimit të arsimit profesional. Projekti "Aftësi për Punë" vazhdon të mbështesë mësuesit në zhvillimin e vazhduar profesional pedagogjik dhe teknik dhe krijimin e kushteve të nevojshme për aplikimin e qasjeve bashkëkohore të të nxënit. Shkollat tona partnere kanë përqaftuar format e reja të mësimdhënies, duke aplikuar metoda novatore e interaktive. Integrimi më i lartë i teknologjisë në mësimdhënie, digjitalizimi i materialeve mësimore dhe orientimi drejt mësimit të kombinuar përfaqësojnë linjat kryesore të zhvillimit në shkollat tona, duke iu përshtatur edhe nevojave dhe preferencave të brezave të rinj.

Ky botim i kushtohet mësimit të kombinuar, si një ndër format novatore të mësimdhënies. Gjashtë mësues të shkollave tona partnere japin dëshmitë e tyre se si ata aplikojnë modele të ndryshme të mësimit të kombinuar. Këto praktika të mira, të shoqëruara me mësim të nxjerra dhe këshilla të vlefshme, do të mund t'ju vijnë në ndihmë si modele për t'u ndjekur, duke ia përshtatur kontekstet në të cilin vepron. Ne do të vazhdojmë të punojmë edhe në të ardhmen në identifikimin dhe mbledhjen e praktikave të tjera të mira dhe në ndarjen e tyre me aktorë të shkollave të mesme profesionale, me besimin se replikimi i këtyre praktikave kontribuon në modernizimin e arsimit profesional.

Ndajmë së bashku të njëjtin mision, atë të ofrimit për brezat e rinj të një edukimi bashkëkohor, që i përgatit ata për të ardhmen për t'u integruar me sukses në tregun e punës dhe për t'u bërë qytetarë të denjë, që kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë. Le të përpiqemi të gjithë ta përmbushim këtë mision!

Përzemërsisht i juaji,
Fation Dragoshi
Menaxher Projekti
Projekti "Aftësi për Punë" (S4J)



Të dashur lexues,

Digjitalizimi është një trend global që nuk ndalet në Ballkanin Perëndimor. Përkundrazi, dixhitalizimi po ndryshon rrënjësisht mënyrat e funksionimit të tregut shqiptar të punës. Ky realitet sigurisht sjell sfida, por gjithashtu mundësi të mëdha për Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP).

Digjitalizimi ofron mundësi të reja në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Nëse mësuesit dhe nxënësit kanë akses në infrastrukturën e TI-së, mësimdhënia e kominuar mund të përmirësojë proceset e të mësuarit dhe të rrisë motivimin për të nxënë. Gjithashtu, në kontekstin ku materialet mësimore duhen përditësuar, mësuesit dhe instruktorët mund të përdorin burime digjitale falas, si dhe të inkurajohen të zhvillojnë materialet e tyre dhe t'i ndajnë ato në internet. Këto, dhe shumë të tjera, tashmë nuk janë më mundësi teorike, por raste të mira që po zhvillohen në institucionet ofruese të AFP-së, të cilat shërbejnë si shembuj frymëzues në AFP për të pëqafuar digjitalizimin si një mundësi që aktualisht po prodhon vlerë në zhvillimin e një oferte cilësore të AFP-së.

Një mirënjohje e madhe shkon për të gjithë mesimdhënësit që tashmë po zhvillojnë këtë realitet digjital të arsimit dhe formimit profesional.

Ejvis Gishti

Drejtor i Përgjithshëm

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

Mësimi i kombinuar

Një zgjidhje efektive për të nxënëit në arsimin profesional

Raste të mira 2022

Ky publikim është prodhuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J) nën mbikëqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Publikimi u përgatit nga Fjorela Pahumi dhe Edlira Kola.

Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J

“Aftësi për Punë” (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

S4J trajton sfidat kryesore të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve.

S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së për krijimin e lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimin dhe përmirësimin e ofertës mësimore, aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimin e praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimin e fuqizimin e institucionit.



+355 00 123 4567

info@skillsforjobs.al

Rr. Skënderbej, Vila nr. 49, Tiranë

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Autorësia e këtij publikimi i përket projektit “Aftësi për Punë” (S4J). Ndalohet riprodhimi dhe shpërndarja e publikimit pa miratim paraprak me shkrim nga S4J.

PËRMBAJTJA

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

6

Edukimi në epokën digjitale ————— 6

Pse po shkojmë drejt mësimi të kombinuar? ————— 6

Vlera e mësimi të kombinuar ————— 7

MODELET E MËSIMIT TË KOMBINUAR

8

Mësimi i kombinuar me rotacion ————— 8

Mësimi i kombinuar fleksibël ————— 9

Mësimi i kombinuar me bazë kurset online ————— 10

Mësimi i kombinuar me bazë zgjidhjen e problemit ————— 11

Mësimi i kombinuar me bazë projektin ————— 12

RASTE TE MIRA

14

Modeli i klasës së përmbysur | Të nxënit përtej kufijve të një ore mësimor ————— 16

Një qasje hibride | Ndërthurja e klasës së përmbysur me modelin e rotacionit sipas stacioneve — 22

Rotacioni sipas stacioneve | Një orë përsëritjeje me veprimtari të shumëllojshme ————— 30

Rotacioni sipas stacioneve | Një orë mësimore ndryshe në lëndën e matematikës ————— 36

Rotacioni në laborator | Aplikimi i njohurive duke u argëtuar ————— 42

Rotacioni individual | Një orë mësimore e moderuar nga vetë nxënësi ————— 48

VËSHTRIM I PËRGGJITHSHËM

Edukimi në epokën digjitale

Zhvillimet e mëdha në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në dekadat e fundit kanë vendosur sistemin e edukimit në pozita reflektimi se si mund ta shfrytëzojmë atë për të formuar brezat e rinj. Të gjendur përballë shoqërisë së informacionit të shekullit të XXI-të dhe brezit të gjeneratës Z, institucionet arsimore hasin vështirësi për t'iu përshtatur profilit të nxënësve dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të tyre. Nëse më parë procesi mësimor kufizohej në libra, fletore dhe dërrasë të zezë, në ditët e sotme kemi pajisje digjitale, të cilat në mjaft raste po zënë vendin e mjeteve tradicionale.

Teknologjia ka filluar të ndryshojë mënyrën se si nxënësit dëshirojnë të marrin informacionin dhe të edukohen. Ata gjithmonë e më shumë kërkojnë të jenë më të pavarur, të aksesojnë informacionin në vendin dhe kohën e dëshiruar, si dhe të kenë fleksibilitet në mënyrën e të nxënësve.

Adaptimi i tyre me platformat e komunikimit social ka shtyrë drejt formave të reja të komunikimit, të ndërveprimit dhe të ndarjes së informacionit. Është e natyrshme të mendohet se, nëse nxënësit ndihen komodë në përdorimin e këtyre platformave për komunikim dhe marrje informacioni të ri, atëherë ata dëshirojnë edhe të mësojnë duke përdorur platforma të tilla. Përdorimi i teknologjisë në ambientet e shkollimit, ashtu si jashtë tyre, do t'i vendoste nxënësit në pozita avantazhuese, si dhe do t'i lejonte të përmirësonin aftësitë e tyre digjitale, të vlefshme gjatë gjithë jetës.



Pse po shkojmë drejt mësimin të kombinuar?

Viti 2020 tronditi sistemin arsimor në mbarë botën. Më shumë se 1.5 miliard nxënës dhe studentë në rreth 194 shtete të botës u prekën nga mbyllja e shkollave dhe e universiteteve për shkak të masave parandaluese të ndërmarra nga shtetet kundër përhapjes së Covid-19 (UNESCO, 2020). Në Shqipëri, numri i nxënësve dhe i studentëve të impaktuar shkoi në rreth 612 mijë e 534 (INSTAT, 2022). Për të siguruar vazhdimësinë e të nxënësve, të gjitha shkollat në vendin tonë iu përgjigjën ndërprerjes së mësimdhënies përmes aplikimit të formave të ndryshme të mësimdhënies në distancë. U përdor një spektër i gjerë mekanizmesh për të realizuar një proces mësimor sa më efikas, gjithëpërfshirës dhe fleksibël, si: mësimet të zhvilluara online duke përdorur platforma të ndryshme komunikimi (Zoom, GoogleMeet, Microsoft Teams, etj.), burime të ngarkuara në faqe dhe platforma të posaçme, transmetime radio-televizive apo kontakte me nxënësit përmes telefonave celularë. Në këtë drejtim, për t'i ardhur në ndihmë arsimin profesional, projekti 'Aftësi për Punë' (S4J) ofroi për të gjithë shkollat partnere dhe jopartnerë platformën online për mësimdhënie MësoVET, ku mësuesit dhe nxënësit



mund të gjenin dhe ta pasuronin atë jo vetëm me përmbajtje interaktive digjitale, por edhe të ndërvepronin nëpërmjet forumeve, kuiceve apo mesazheve.

Pavarësisht pasojave në fushën e edukimit, periudha e pandemisë ka qenë edhe një kohë e mësimëve të vlefshme dhe e mundësive të reja. Edhe pse mbetet shumë për t'u përmirësuar në kuadër të realizimit të një procesi mësimor online cilësor, për të gjithë nxënësit dhe mësuesit vazhdimësia e orës mësimore u bë e mundur vetëm falë kësaj qasjeje të re dhe mundësive që teknologjia e informacionit dhe e komunikimit ofron. Njëkohësisht, u vërtetua se teknologjia mund të ndihmojë në procese të ndryshme si: planifikimi, realizimi, monitorimi dhe dokumentimi.

Përshtatja e shpejtë e nxënësve dhe e mësuesve, si dhe puna e madhe e tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime, bëri që një gjeneratë e tërë të përmirësojë aftësitë e tyre digjitale dhe të konsiderojë aplikimin e formave të reja të mësimdhënies dhe të nxënimit. Njohja me mësimin online dhe përdorimi i teknologjisë në funksion të saj shënoi një ndryshim në sjelljen e të gjithë aktorëve në fushën e edukimit, të cilët konstatuan përfitimet që mësimi online ofron.

Por a mund të zëvendësojë mësimi online formën tradicionale të mësimin në klasë me të njëjtin efektivitet? Përgjigjja është jo, por natyrisht që integrimi i metodave dhe i veprimtarive online në qasjet tradicionale ballë për ballë i shton vlerë procesit mësimor. Merr trajtë, kështu, një modalitet i ri – mësimi i kombinuar – si një ndër format më efikase të mësimdhënies dhe të nxënimit.

Vlera e mësimin të kombinuar

Mësimi i kombinuar, si ndërthurje efikase e metodave dhe veprimtarive ballë për ballë me ato online, si brenda, ashtu edhe jashtë institucionit arsimor, mund të jetë forma më e përshtatshme për të edukuar brezin e gjeneratës Z. **Mësimi i kombinuar ofron pikërisht atë që nxënësit e sotëm, por edhe mësimdhënësit, kërkojnë: një qasje interaktive, kreative, gjithëpërfshirëse dhe njëkohësisht më të personalizuar, si dhe fleksibilitet në raport me kohën dhe vendin për të nxënë.** Në mësimin e kombinuar, mjedisi mësimor

integron elementet dhe procese të të nxënimit, si dhe mjedise dhe platforma digjitale për mësimdhënie, ndërveprim dhe komunikim. Nxënësit, të ndihmuar nga përdorimi i gjerë i teknologjisë, vendosen natyrshëm në qendër të procesit mësimor dhe marrin pjesë aktive në ndërtimin e njohurive të reja dhe në konsolidimin e aftësive dhe të kompetencave.

Gjithsesi mësimi i kombinuar kërkon ndërgjegjësim dhe informim, si në nivel individual, ashtu edhe në plan insitucional, aq më tepër që bëhet fjalë për një sektor ku ndryshimet nuk ndodhin lehtë. Njëkohësisht, për aplikimin me sukses të mësimin të kombinuar nevojitet edhe një planifikim i mirëmenduar nga ana e mësimdhënësve, si dhe aftësi digjitale të mira. Nga ana tjetër, drejtuesit e institucionit arsimor duhet të garantojnë disponueshmërinë e teknologjisë së nevojshme për mësimin e kombinuar/online, i cili është një element kyç për të lehtësuar kalimin nga modaliteti ballë për ballë në atë online.



MODELET E MËSIMIT TË KOMBINUAR

Mësimi i kombinuar me rotacion (Rotation Blended Learning)

Gjatë aplikimit të këtij modeli nxënësit kalojnë nga një veprimtari në tjetrën, sipas udhëzimeve të mësimitdhënësit. Në përgjithësi, veprimtaritë realizohen në të njëjtën kohë për të gjithë nxënësit.

Këto veprimtari mund të jenë të ndryshme, si: projekt në grup, praktikë individuale, dhënie udhëzimesh në një mjedis virtual apo prezantim, ku të paktën njëra zhvillohet online. Në këtë mënyrë, nxënësit i jepet mundësia të konsultohet me mësimitdhënësin, të ndërveprojë me grupin dhe të punojë në mënyrë të pavarur.

Ka katër forma (nënmodele) të realizimit të mësimit të kombinuar me rotacion: Rotacion sipas stacioneve (Station rotation), Rotacion në laborator (Lab rotation), Klasa e përmbysur (Flipped classroom), Rotacioni individual (Individual rotation).

HAPAT E NDJEKUR

- I. Përcaktimi i veprimtarive dhe i mënyrës së zhvillimit të tyre.
- II. Përcaktimi i kohës për realizimin e secilës veprimtari.
- III. Përgatitja e një kalendari pune për të kontrolluar progresin.
- IV. Përcaktimi i formave të vlerësimit

AVANTAZHET

- lehtësi në monitorimin e nxënësve falë ritmit të njëjtë të punës;
- përkushtim i mësimitdhënësit ndaj nxënësve që kanë më tepër nevojë;
- nxitje e angazhimit të nxënësve;
- ndërthurje e nxënësve sipas niveleve brenda të njëjtit grup.

DISAVANTAZHET

- shpërqëndrim për të shkak të veprimtarive të shumta;
- vështirësi në menaxhimin e kohës;
- probleme të mundshme teknike gjatë kalimit nga modalitet në tjetrin.



Mësimi i kombinuar fleksibël (Flex Blended Learning)

Zhvillohet në klasë, me mbështetje të gjerë në teknologji, ku çdo nxënës ka postin e vet të punës. Në këtë model, nuk ka orar të përcaktuar të fillimit apo të mbarimit të orës së mësimi.

Mësimdhënësi nuk shpjegon në formë tradicionale, por shpërndan udhëzime dhe detyra në mjedisin virtual, ndërsa nxënësi përzgjedh se si të punojë me to, cilat burime të tjera të konsultojë, si t'i realizojë detyrat etj.

Pra, nxënësi përcakton vetë mënyrën dhe ritmin, për një proces të nxëni të personalizuar. Pas dhënies së udhëzimeve dhe të materialeve në mjedisin virtual, mësimdhënësi mbikqyr nxënësit dhe ndërhyr në rast nevojë. Disa veprimtari mund të prezantohen në klasë dhe disa të tjera mund të ngarkohen në mjedisin virtual.

HAPAT E NDJEKUR

- I. Përcaktimi i veprimtarive që do të zhvillohen.
- II. Përcaktimi i udhëzimeve për secilën veprimtari.
- III. Përgatitja e një kalendari pune për të kontrolluar progresin.
- IV. Përcaktimi i formave të vlerësimit.

AVANTAZHET

- fleksibilitet i lartë në raport me kohën, vendin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë;
- personalizim i të nxëni;
- nxitje e punës së pavarur;
- rritje e vetëbesimit të nxënësit.

DISAVANTAZHET

- vështirësi në kapërcimin e mendësisë tradicionale të zhvillimit të mësimi;
- menaxhim i vështirë i kohës në kushtet e një orari të papërcaktuar mësimi;
- ulje e motivimit të nxënësve;
- ndërveprim fizik i kufizuar.



Mësimi i kombinuar me bazë kurset online (A la carte Blended Learning)

Ndjekja e kurseve online ka si qëllim transferimin e pjesës më të madhe të veprimtarive në mjedisin mësimor virtual. Veprimtaritë online konsistojnë në njohjen me materialin mësimor, trajtimin e tematikave, diskutime, forume dhe vlerësim, ndërsa koha në klasë, ballë për ballë, i kushtohet trajtimit të çështjeve në të cilat nxënësit hasin vështirësi, shkëmbimit të përvojave apo veprimtarive plotësuese.

HAPAT E NDJEKUR

- I. Përcaktimi i veprimtarive që do të zhvillohen.
- II. Përcaktimi i udhëzimeve për secilën veprimtari.
- III. Përcaktimi i grafikut të kombinimit të mjedisit virtual me mjedisin fizik në klasë.
- IV. Përgatitja e një kalendari pune për të kontrolluar progresin.
- V. Përcaktimi i formave të vlerësimit.

AVANTAZHET

- mundësi për të kompensuar mungesën fizike në klasë;
- nxitje e punës së pavarur;
- personalizim i procesit të të nxënit.

DISAVANTAZHET

- vështirësi në ndarjen kohore të veprimtarive jashtë dhe brenda mjedisit të institucionit arsimor;
- nevojë për aftësi të kënaqshme digjitale nga ana e të gjithë nxënësve online.



Mësimi i kombinuar me bazë zgjidhjen e problemit (Problem-based Learning)

Në këtë formë të mësimit të kombinuar, përgjithësisht, puna me materialet teorike realizohet online, në mënyrë të pavarur ose në grup, ndërsa qëndrimi në klasë shfrytëzohet për praktika në lidhje me detyrën e dhënë. Nxënësit organizohet në grupe të vogla (4-6 pjesëtarë), të cilët punojnë së bashku për disa orë mësimi duke qartësuar problemin, mbledhur informacion, hulumtuar dhe analizuar, shqyrtuar alternativa të mundshme për zgjidhjen e problemit, përzgjedhur dhe zbatuar atë që e gjykojnë si më të përshtatshme, dhënë vlerësim mbi performancën e grupeve të tjera etj. Roli i mësimdhënësit konsiston në monitorimin dhe menaxhimin e grupeve të punës, në këshillimin e nxënësve, si dhe në vlerësimin mbi bazë procesi dhe produkti final.

HAPAT E NDJEKUR

- I. Përcaktimi i mënyrës së paraqitjes së problemit (skenar, rast studimor, eksperiment, grafik, imazh etj.).
- II. Përgatitja e udhëzimeve.
- III. Përcaktimi i ndarjes së nxënësve në grupe pune.
- IV. Përgatitja fazave të punës me kombinime të mjedisit virtual me mjedisin fizik në klasë.
- V. Përgatitja e një kalendari pune për të kontrolluar progresin.
- VI. Përcaktimi i formave të vlerësimit.

AVANTAZHET

- nxitje e të mësuarit të thelluar;
- fitim i njohurive më të qëndrueshme;
- vendosje e nxënësit në pozita pune, duke u përballur me probleme të botës reale;
- konsolidim i aftësive të buta si: të punuarit në grup, mendimi kreativ, mendimi kritik, vendimmarrja etj.;
- përmirësim i aftësive digjitale të nxënësit;
- fokusim mbi procesin, jo vetëm mbi produktin.

DISAVANTAZHET

- ngarkesë pune dhe konsum i madh kohe për përgatitjen e orës mësimore;
- performancë e ulët e nxënësve në testime mbi njohuritë teorike;
- shpërqëndrim i nxënësve në përpjekje për të zgjidhur problemin.



Mësimi i kombinuar me bazë projektin (Project-based Learning)

Në këtë model ndërthuret të nxënës online, nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve të ndryshme, me atë tradicional ballë për ballë, me qëllim dizenjimin, realizimin dhe prezantimin e detyrave apo produkteve në kuadër të një projekti të kontekstualizuar në botën reale, me natyrë multidisiplinare.

Nxënësit fitojnë njohuri dhe aftësi duke punuar për një kohë të caktuar nëpërmjet investigimeve, problemeve apo sfidave, duke u aktivizuar nëpërmjet diskutimeve, praktikimit të aplikacioneve të ndryshme, krijimit të dokumentacioneve etj.

HAPAT E NDJEKUR

- I. Përzgjedhja e një tematike multidisiplinare.
- II. Përcaktimi i objektivave të qartë.
- III. Përcaktimi i udhëzimeve.
- IV. Përcaktimi i pyetjeve orientuese.
- V. Përgatitja e fazave të punës me kombinime të mjedisit virtual me mjedisin fizik në klasë.
- VI. Përgatitja e një kalendari pune për të kontrolluar progresin.
- VII. Përcaktimi i formave të vlerësimit.

AVANTAZHET

- konsolidim i aftësive të buta të nxënësit (fryma e punës në grup, komunikimi, marrja e përgjegjësisë, të menduarit kritik etj.);
- nxitje e motivimit dhe e angazhimit të nxënësve;
- rritje e performancës së nxënësve.

DISAVANTAZHET

- koha e gjatë që mund të marrin kërkimet dhe diskutimet;
- vështirësi në menaxhimin e klasës;
- vështirësi në vlerësimin individual të nxënësit kur puna realizohet në grupe.





RASTE TË MIRA

Gjatë periudhës tetor-nëntor 2021, projekti “Aftësi për Punë” organizoi në shkollat profesionale partnere, Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë dhe “Gjergj Canco”, një trajnim 3-ditor mbi mësimin e kombinuar, me fokus përvetësimin e koncepteve kyçe të tij, planifikimin dhe aplikimin në praktikë.

Në vijim të trajnimit, një pjesë e mësuesve nisi të aplikonte në orë konkrete mësimore modele të ndryshme të mëimit të kombinuar, duke u asistuar nga trajnuesit.

Rastet e mira të paraqitura në këtë publikim bazohen në:

- **Mënyra e konceptimit**

- **Planifikimi i orës mësimore**

- **Realizimi i mëimit të kombinuar**

- **Mësimet e nxjerra dhe këshilla**



MODELI I KLASËS SË PËRMBYSUR

Të nxënit përtej kufijve të një ore mësimore

Dareko Pëllumbi

Drejtimi: Ekonomi – Biznes

Lënda: Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Tema: Roli i komunitetit në mbrojtjen e mjedisit



Format e reja të mësimdhënies bazohen jo vetëm në mësimdhënien ballë për ballë, por edhe në atë në distancë, duke shfrytëzuar edhe avantazhet e të nxënit online. Ato janë qasje inovative të të mësuarit me bazë teknologjinë digjitale dhe kanë në thelb angazhimin e nxënësve në procesin e të nxënit, duke e vendosur mësuesin në rolin e facilituesit. Duke kombinuar metoda dhe forma të ndryshme të të mësuarit aktiv, krijohen mundësi për një eksperiencë të nxëni efektive, që shtrihet përtej kufijve të orës së mësimin.

Prej shumë vitesh, Dareko Pëllumbi ushtron profesionin e mësueses në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë. Përvoja i ka mësuar se në një orë tradicionale, me mësuesin në qendër, nxënësi nuk është i motivuar dhe shfaq vështirësi në përqëndrim dhe në përthithjen e njohurive. Për këtë arsye, mësuese Dareko aplikon qasje të reja në mësimdhënie për t'iu përshtatur

sa më shumë preferencave të brezave të rinj, duke bërë e teknologjinë dhe multimedian pjesë integrale të orës mësimore.

Në lëndën 'Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm', mësuesja aplikon klasën e përmbysur në tema të caktuara, duke ndërthur veprimtaritë online para orës së mësimin me veprimtaritë tradicionale ballë për ballë në klasë. Në kuadër të realizimit të veprimtarive në distancë, mësuese Dareko përdor materiale mësimore digjitale, të cilat i sjell në forma të ndryshme si: prezantime interaktive, animacione, videoregjistrime, audioregjistrime, diagrama apo harta mendore.

Përmbajtja digjitale përgatitet në varësi të temës që do të trajtohet. Mësuese Dareko ndan me ne ekperiencën e saj në aplikimin e klasës së përmbysur në temën 'Roli i komunitetit në mbrojtjen e mjedisit'.

Planifikimi i orës mësimore

Sipas mëuese Darekos, procesi i planifikimit të një ore mësimore bazuar në modelin e klasës së përmbysur ndryshon dukshëm nga ai bazuar në modele të tjera të mësimin të kombinuar.

Puna parapërgatitore e mësuesit duhet të realizohet në mënyrë të kujdesshme, për të ofruar në mjedisin virtual materialin mësimor ku do të bazohet puna paraprake e nxënësve dhe udhëzimet përkatëse për ndërtimin e orës së ardhshme mësimore.

Me qëllim nxitjen e aftësive reflektuese, analizuese dhe deduktuese të nxënësit përpara ardhjes në orën mësimore, si dhe ofrimin e një materiali në formë sa më tërheqëse për ta, mësuesja ka vendosur që puna e pavarur e nxënësve të realizohet nëpërmjet ndjekjes së videove, të cilat përmbajnë njohuritë bazë që do të të përforcohen më tej në klasë. Krahas përzgjedhjes së videove dhe dhënies së udhëzimeve nëpërmjet platformës, mësuesja planifikon në mënyrë të detajuar edhe veprimtaritë që do të realizohen nga nxënësit gjatë qëndrimit të tyre në klasë, me synimin kryesor aktivizimin e tyre dhe shkëmbimin e ideve me njëri-tjetrin. Gjatë procesit të planifikimit, siç dëshmon mësuesja, thelbësore është të përcaktohet se cili është modaliteti i duhur për zhvillimin e secilës veprimtari, në mënyrë që ora të rezultojë sa më efektive.



Realizimi i mësimit të kombinuar

Veprimtaritë në distancë (para ardhjes në klasë)

Veprimtaria 1: Ndjekje videoje



Modaliteti: Online (platforma MësoVET)

Kohëzgjatja: E papërcaktuar (sipas ritmit të nxënësit)

Mënyra e zhvillimit: Me qëllim shfrytëzimin e kohës në klasë për diskutime dhe konsolidim njohurish të reja, mësuesja, me anë të videove, i njeh nxënësit me informacionin e ri para ardhjes së tyre në orën e mësimit. Mësuesja ka edituar paraprakisht 5 video të shkurtra mbi temën e re të mësimit, nëpërmjet programit Slido, duke integruar linkun e tyre në materialet mësimore në platformën MësoVET. Njëkohësisht, mësuesja ka realizuar edhe ndarjen e nxënësve në 5 grupe, ku secili prej tyre duhet të punojë mbi njërin nga videot. Për secilën video ka përgatitur edhe një set pyetjesh për të orientuar nxënësit gjatë diskutimit në klasë.



Veprimtaria 2: Reflektim mbi konceptet e reja

Modaliteti: Online (platforma MësoVET)

Kohëzgjatja: E papërcaktuar (sipas ritmit të nxënësit)

Mënyra e zhvillimit: Secili nxënës ndjek videon e ngarkuar në platformë, në vendin dhe kohën e përzgjedhur prej tyre, duke patur mundësi t'i rikthehen disa herë përmbajtjes së saj. Me anë të kësaj qasjeje, nxënësit i jepet mundësia të njihet me materialin e ri në mënyrën që i përshtatet më shumë dhe sipas ritmit të tij: një nxënës ndjek videon online me ndalesa duke mbajtur paralelisht shënime, një nxënës tjetër i rikthehet disa herë videos për të zbërthyer përmbajtjen e saj, dikush skicon një hartë mendore me konceptet kryesore pas ndjekjes së videos, ndërsa dikush tjetër realizon edhe një hulumtim online mbi konceptet me të cilat u njoh gjatë videos.





Veprimtaria 3: Ndjekja e videove

Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 3' çdo video (15' gjithsej)

Mënyra e zhvillimit: Me fillimin e orës së mësimit, mësuesja nis të projektojë nëpërmjet platformës videon me të cilën ishin njohur vetëm nxënësit e grupit të parë, duke u drejtuar pyetjet e parapërgatitura pjesëtarëve të këtij grupi. Nxënësit e grupeve të tjera njihen për herë të parë me kontentin e kësaj videoje.

Veprimtaria 4: Diskutim mbi videot



Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5' për video (25' gjithsej)

Mënyra e zhvillimit: Nxënësve të grupeve të tjerë, duke u njohur me përmbajtjen e videos, u jepet mundësia t'u shtrojnë pyetje pjesëtarëve të grupit dhe të diskutojnë me ta dhe mësuesen. Në këtë mënyrë, nxënësit nuk presin në mënyrë pasive transferimin e njohurive të reja nga mësuesja tek ata, por marrin pjesë aktive në ndërtimin e tyre, ndihmuar edhe nga orientimet e mësueses. Mësuesja plotëson përgjigjet e nxënësve, thekson konceptet dhe idetë kryesore, moderon diskutimin dhe veçon përgjigjet më të mira, duke realizuar kështu edhe vlerësimin e punës së nxënësve. Ora vijon me ndjekjen e videove të tjera, sipas të njëjtës logjikë, ku të gjithë nxënësit ndërveprojnë dhe shprehin mendimin e tyre mbi përmbajtjen e secilës video.



Veprimtaria 5: Caktim i detyrave të shtëpisë

Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Në fund të orës së mësimit, mësuesja, në formë tradicionale ballë për ballë, realizon një përmbledhje të njohurive kryesore të përftuara. Gjithashtu, u cakton nxënësve detyrën të cilën ata do të zhvillojnë për orën e ardhshme, duke i orientuar mbi vendndodhjen e saj në platformë dhe mbi mënyrën e ngarkimit.


Përdorimi i teknologjive multimediale në procesin mësimor

Përmbajtja e ardhur në formën e një videoje ka transformuar mënyrën se si nxënësit mësojnë. Pasiviteti i nxënësve gjatë një ore mësimore tradicionale, si pasojë e mungesës së mekanizmave që nxitin angazhimin e tyre, vështirësia për t'u përqëndruar gjatë dhe nevoja e nxënësve për personalizim të ritmit të të nxënit, kanë shtyrë mësuesit në integrimin e mjeteve multimediale në procesin mësimor dhe në veçanti, të videove.

Rezultati: nxënës më të motivuar, angazhim më i lartë dhe përvojë të nxëni më efektive. Natyra audio-vizuale e videos ndihmon në asimilimin e shpejtë të njohurive, pasi informacioni vjen në formë të rrjedhshme, më tërheqëse, që nxit diskutimin, mendimin kritik dhe atë kreativ.

E përdorur në kuadër të klasës së përmbysur, ndjekja e videove u lejon nxënësve të aksesojnë dhe përpunojnë njohuritë e reja sipas ritmit të tyre, si dhe nxit punën e pavarur. Gjithashtu, diskutimet e mbështetura në përmbajtjen e videove mund të shërbejnë edhe si forma të vlerësimit të vazhduar, ndërkohë që nxitin edhe vlerësimin midis nxënësve.

Disa mësues madje po përdorin platforma si YouTube për t'i qasur nxënësit në kanale që vetë ata ndjekin, për t'u zhvilluar profesionalisht ose për t'i përditësuar me të reja të fushës. Përdorimi i mjeteve të tilla po ndikon në transformimin e përcjelljes dhe përvetësimit të njohurive, duke e shndërruar atë në proces dinamik, proaktiv të ndërtimit të njohurive nga vetë nxënësit.



Mësime të nxjerra dhe këshilla

1


Njohja me informacionin e ri para ardhjes në klasë krijon fleksibilitet dhe pavarësi. Të nxëniet realizohet në mënyrë të personalizuar, në ritmin e dëshiruar, si dhe me ndërveprim më të mirë me materialin. Nxënësit vijnë të përgatitur dhe angazhohen në diskutime gjatë orës mësimore.

2

Përdorimi i videos për realizimin e modelit të klasës së përmbysur është tërheqës dhe angazhues për nxënësit. Gjithsesi për aplikimin me sukses të formatit të përdorur nga mësuese Dareko, kërkon që mësime të ketë aftësi të kënaqshme digjitale për të përzgjedhur dhe edituar videot. Njëkohësisht, edhe nxënësit duhet të jenë të aftë të punojnë në mënyrë të pavarur me platformën mësimore.

3

Krahas kompetencave digjitale, zbatimi i kësaj forme të klasës së përmbysur kërkon infrastrukturën e duhur digjitale për të mbështetur nxënësit gjatë punës së pavarur (pajisje të lidhura me internetin), si dhe gjatë kohës së shpenzuar në klasë.



NJË QASJE HIBRIDE

Ndërthurja e klasës së përmbysur me modelin e rotacionit sipas stacioneve

Dorela Maçka



Drejtimi: Ekonomi – Biznes

Lënda: Ekonomi ndërmarrjeje

Tema: Aftësitë menaxheriale

Në dy vite, aplikimi i mësimit të kombinuar në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë ka ardhur në rritje. Ndonëse fillimisht u realizua diktuar nga rrethanat, ku prezanca fizike e nxënësve në ambientet e shkollës dhe kohëzgjatja e orës mësimore ishte e kufizuar, metoda e mësimit të kombinuar vazhdon të aplikohet nga mësueset e kësaj shkolle, edhe pas rikthimit në kushtet normale të procesit mësimor. Një ndër to është edhe Dorela Maçka, mësuese në drejtimin Ekonomi-Biznes, me dëshirën për të kontribuar në edukimin e brezave të rinj nëpërmjet formave të reja të mësimdhënies. Për këtë arsye ajo i përfshin shpeshherë nxënësit e saj në veprimtari mësimore online, gjatë orës mësimore dhe përtej saj, duke i dhënë vlerë të shtuar procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Falë pjesëmarrjes në trajnimin “Mësimi i kombinuar në praktikë”, mësuese Dorela ka përvetësuar mënyrën e aplikimit të modeleve të ndryshme të mësimit të kombinuar. Në lëndën

Ekonomi ndërmarrjeje, për të trajtuar temën “Aftësitë menaxheriale”, mësuesja ka përzgjedhur të aplikojë një model që mund të konsiderohet “hibrid”: një ndërthurje e klasës së përmbysur me modelin e rotacionit sipas stacioneve.

Në njërin plan, në modelin e klasës së përmbysur të mësimit të kombinuar, nxënësit së pari punojnë online në mënyrë të pavarur me materialin e ri, sipas udhëzimeve të mësimdhënësit dhe më pas, në kontakt me mësimdhënësin, në formë tradicionale ballë për ballë, thellohen në njohuritë e marra ose i vënë ato në praktikë. Njohja me konceptet e reja jashtë mjediseve të shkollës, ku nxënësi ka fleksibilitet në raport me kohën, vendin dhe ritmin e të nxënësve, luan një rol avantazhues për të gjithë. Në këtë mënyrë, mësuese Dorela dhe nxënësit kanë më shumë kohë në dispozicion për realizimin e veprimtarive që gjykohen më me vlerë të realizohen në klasë, si diskutime, ushtrime, prezantime etj.

Në plan tjetër, në kuadër të mësimit me rotacion sipas stacioneve, ora e mësimit planifikohet në mënyrë të tillë që nxënësit të zhvendosen të gjithë së bashku nga një veprimtari (stacion) në tjetrën, herë në formë tradicionale ballë për ballë e herë online, sipas një harku kohor të përcaktuar nga mësuesi. Zbatimi i këtij modeli mundëson angazhim më të lartë të nxënësve dhe dinamikë në procesin e të nxënësve.

Planifikimi i orës mësimore

Krahasuar me një orë mësimore tradicionale, procesi i dizenjimit të një klase të përmbysur prek disa aspekte të reja, të cilat duhen marrë në konsideratë gjatë planifikimit të orës mësimore. Kur mësuesi planifikon një orë mësimore në formën e përmbysur, fokusi nuk bie vetëm në planifikimin e veprimtarive që do të realizohen në klasë. Po aq rëndësi ka identifikimi i veprimtarive që nxënësi duhet të realizojë paraprakisht, si dhe orientimi i nxënësve gjatë këtij procesi, me qëllim përgatitjen sa më të mirë të tyre për të nxënësve aktiv në klasë.

Sipas mësuese Dorelës, për një klasë të përmbysur të suksesshme, mësuesi duhet:

- të përzgjedhë dhe të planifikojë me kujdes veprimtaritë që nxënësit do të realizojnë në klasë dhe ato që do të realizojnë asinkron, jashtë mjediseve të shkollës;
- të përgatitë materialet me të cilat nxënësi do të njihet në distancë (online ose jo);
- të përgatitë instruksione të qarta dhe të detajuara rreth veprimtarive që ata duhet të realizojnë, duke theksuar edhe se çfarë pritet prej tyre.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përzgjedhja me kujdes e platformave dhe instrumenteve të tjerë digjitale për t'i ardhur në ndihmë realizimit të veprimtarive. Nga ana tjetër, një planifikim po aq i kujdesshëm nevojitet edhe edhe për fazën e procesit mësimor që realizohet në klasë, ku përcaktimi i modalitetit sipas të cilit do të zhvillohet secila veprimtari duhet të jetë në funksion të rritjes së efektivitetit të procesit mësimor në tërësi. Në një format të tillë hibrid të mësimit të kombinuar, që supozon të ndërthurë pikat e forta të secilit model, procesi mësimor është sfidues, por njëkohësisht edhe më angazhues.

Realizimi i mësimit të kombinuar

Veprimtaritë në distancë (para ardhjes në klasë)

Veprimtaria 1: Kërkim i pavarur online mbi konceptet kyçe të temës së re



Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: E papërcaktuar (sipas ritmit të nxënësit)

Mënyra e zhvillimit: Aplikimi i modelit të klasës së përmbytur nga mësuese Dorela ka nisur me dhënien e orientimeve për realizimin e veprimtarive nga ana e nxënësve përpara orës së mësimit, pra jashtë klasës. Me synimin për t'i familjarizuar paraprakisht nxënësit me njohuritë që do të merren në temën e re dhe për të nxitur te ta punën e pavarur, mësuesja ka udhëzuar nxënësit mbi zhvillimin e një kërkimi online, duke u dhënë konceptet kyçe në të cilat do të mbështeten.



Veprimtaria 2: Realizimi i një prezantimi mbi bazën e kërkimit online

Modaliteti: Online/offline (nëpërmjet teknologjisë)

Kohëzgjatja: E papërcaktuar (sipas ritmit të nxënësit)

Mënyra e zhvillimit: Nxënësve u është kërkuar të realizojnë një prezantim të shkurtër të punës së tyre të pavarur kërkimore, në një program të zgjedhur prej tyre, mbi konceptet e dhëna. Në përputhje me parimet bazë të mësimit të kombinuar, nxënësve u jepet kështu mundësi përzgjedhjeje mbi kohën dhe vendin ku dëshiron të punojë, si dhe mbi programin për të realizuar prezantimin. Në këtë mënyrë nxënësit përvetësojnë edhe aftësitë e tyre digjitale, përpos atyre kërkimore.





Veprimtaria 3: Aktivizim i njohurive ekzistuese

Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Ora e mësimit nis me aktivizimin e njohurive ekzistuese, në mënyrë tradicionale ballë për ballë. Mësuese Dorela evokon njohuritë e fituara më parë nëpërmjet pyetjeve drejtuar nxënësve. Nxënësit japin përgjigje të argumentuara, duke ndërvepruar me mësuesen dhe me njëri-tjetrin nëpërmjet plotësimeve dhe saktësimeve.

Veprimtaria 4: Përcjellja e njohurive të reja mbi temën mësimore



Modaliteti: Tradicional ballë për ballë + online

Kohëzgjatja: 20'

Veprimtaria 4a: Prezantim i detyrës së realizuar mbi bazën e kërkimit të pavarur online

Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Ora vijon me përcjelljen e njohurive të reja mbi temën mësimore, e cila është planifikuar nga mësuesja të zhvillohet në dy faza. Fillimisht, mësuesja fton njërin prej nxënësve të prezantojë detyrën e realizuar mbi bazën e kërkimit të pavarur online. Nëpërmjet videoprojektorit, me anë të një prezantimi sintetik realizuar në Google Slides, nxënësja nis kështu ndërtimin e njohurive të reja. Paralelisht, mësuesja dhe nxënësit diskutojnë duke komentuar mbi rezultatet e kërkimit dhe duke konsoliduar konceptet nëpërmjet rezultateve të punës së pavarur të secilit.

Veprimtaria 4b: Dhënia e informacionit të ri

nga ana e mësueses

Modaliteti: Ballë për ballë

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Pas prezantimit nga ana e nxënëses, është mësuesja që vijon me përcjelljen e njohurive të reja, në modalitet ballë për ballë, por mbi bazën e materialeve mësimore të vendosura në platformën digjitale MësoVET. Mbi bazën e një skice të paraqitur nëpërmjet platformës, realizohet edhe një diskutim me nxënësit, të cilët interpretojnë përmbajtjen e skicës. Njëkohësisht, mësuesja orienton nxënësit për mënyrën se si nxënësit mund ta shfrytëzojnë materialin mësimor të vendosur në platformë, gjatë punës së pavarur, pas përfundimit të orës mësimore.

Veprimtaria 5: Matja e njohurive të fituara



Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Me qëllim matjen e njohurive të fituara, mësuese Dorela fton nxënësit të logohen në platformën MësoVET dhe jep instruksionet për t'u bërë pjesë e një forumi online. Të gjithë nxënësit angazhohen në këtë veprimtari, duke dhënë inputin e tyre mbi pyetjen e shtruar në forum, ndërkohë që mësuesja i ndjek nëpërmjet platformës.



Veprimtaria 6: Diskutim mbi përgjigjet e dhëna në forum

Modaliteti: Ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Në përmbyllje, duke iu referuar përgjigjeve të nxënësve në forumin e hapur në platformën MësoVET, të shfaqura në klasë nëpërmjet videoprojektorit, në modalitet tradicional ballë për ballë, mësuesja komenton, plotëson dhe veçon inputet më të mira.

Hulumtimi i pavarur online: një formë efikase e të nxënimit të pavarur

Mësuese Dorela ka testuar forma të ndryshme për të realizuar fazën e njohjes dhe të përvetësimit të informacionit të ri nga ana e nxënësve. Për të, me nxënësit e klasës së X-të në lëndën Ekonomi ndërmarrjeje, më efikas ka rezultuar hulumtimi i pavarur online. Sipas mësueses, kjo veprimtari i jep një pavarësi të plotë nxënësit për të kërkuar dhe gjetur informacionin rreth koncepteve të reja të temës në formën dhe mënyrën e tij të preferuar, si dhe sipas ritmit që i përshatet.

Këto mundësi përzgjedhjeje i krijojnë hapësirë nxënësve të zbulojnë metodën e tyre të preferuar të të nxënimit dhe marrjes së informacionit. Gjithashtu nxit kuriozitetin dhe zgjeron horizontin nëpërmjet pafundësisë së informacionit që mund të aksesojnë online.

Gjatë këtij rrugëtimi nxënësit edhe gabojnë në përzgjedhjen e burimeve të informacionit, një mësim ky shumë i vyer sipas mësuese Dorelës pasi sheh se nxënësit përmirësohen çdo ditë e më shumë në përzgjedhjen e informacionit. Për mësuese Dorelën kjo veprimtari ka rezultuar shumë efektive, duke zhvilluar te nxënësit afësinë për të punuar në mënyrë të pavarur, angazhimin në diskutime dhe vetëbesimin.



Mësime të nxjerra dhe këshilla

1

Aplikimi i klasës së përmbysur, e cila ka në bërthamën e saj njohjen me informacionin e ri dhe përpunimin e tij nga nxënësi para fillimit të orës së mësimit, është sfidues për mësuesin, duke qenë se suksesi i orës së mësimit varet ndjeshëm nga puna individuale e pavarur që nxënësi realizon. Dhënia e instruksioneve të qarta dhe evidentimi i pritshmërive të punës së nxënësve kontribuon në realizimin me sukses të këtij modeli.

2


Njohja paraprake me informacionin e ri krijon më shumë hapësirë gjatë orës së mësimit për realizimin e aktiviteteve të fokusuara jo vetëm në përvetësimin e kompetencave lëndore, por edhe të atyre të jetës. Komunikimi, puna në grup apo kreativiteti duhet të jenë në fokus gjatë planifikimit të veprimtarive mësimore.

3

Kombinimi i veprimtarive tradicionale ballë-për-ballë me ato online kontribuon në zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësit dhe i shtyn ata drejt punës kërkimore në kuadër të ndërtimit të njohurive. Nxitja e përdorimit të platformave të ndryshme digjitale dhe burimeve të ndryshme të informacionit është avantazhuese në këtë aspekt.

4

Krahas klasës së përmbysur, mësuese Dorela sugjeron gjithashtu aplikimin e modelit të rotacionit sipas stacioneve gjatë orës së mësimit, duke kombinuar modalitetin ballë për ballë dhe atë online. Në këtë mënyrë, nxënësit përfitojnë maksimalisht nga procesi mësimor edhe gjatë qëndrimit në klasë.





ROTACIONI SIPAS STACIONEVE

Një orë përsëritjeje me veprimtari të shumëllojshme

Etra Vendresha



Drejtimi: TIK

Lënda: Gjuhë angleze

Tema: Përsëritje

Institucionet arsimore gjithnjë e më shumë po integrojnë modelet e mësimit të kombinuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke kombinuar aktivitetet ballë për ballë me ato online. Investimet në infrastrukturën fizike në shkolla dhe zhvillimi i platformave të ndryshme për mësimdhënie kanë mundësuar përdorimin e gjerë që kjo qasje ofron dhe marrjen e benefiteve prej saj si nga ana e mësuesve, ashtu edhe e nxënësve.

Nëse teknologjia më parë shërbente vetëm si një urë lidhëse mes mësimdhënësit, nxënësit dhe materialit mësimor, tashmë ajo është një komponent thelbësor në procesin mësimor. Gjithsesi realizimi me sukses e kësaj forme të re të nxëni kërkon aftësi digjitale nga ana e mësuesve dhe nxënësve, si dhe që palët të jenë të hapura drejt së resë.

Ekzistojnë modele të ndryshme të aplikimit të mësimit të kombinuar, për t'iu përgjigjur temave të ndryshme

mësimore të trajtuara gjatë një ore mësimore. Pas pjesëmarrjes në trajnimin “Mësimi i kombinuar në praktikë”, mësuese Etra përvetësoi njohuri në aplikimin e këtyre modeleve, të cilat i vendos në praktikë sot me nxënësit e saj. Për të realizuar një orë përsëritje në lëndën e Anglishtes, mësuese Etra ka përzgjedhur metodën e ‘Rotacionit sipas stacioneve’, duke e konsideruar si më efikasen në riaktivizimin dhe përforcimin e njohurive.

Nga njëra anë, përdorimi i kësaj qasjeje mundëson shfrytëzim më të mirë të kohës dhe lehtësi në monitorimin e nxënësve, duke qenë se të gjithë nxënësit gjenden në një veprimtari brenda të njëjtit hark kohor. Nga ana tjetër, ajo sheh një aktivizim më të lartë të nxënësve, të cilët tërhiqen nga larmia e veprimtarive.

Planifikimi i orës mësimore

Për të dizenuar mësimin e kombinuar me rotacion sipas stacioneve, mësuese Etrës i duhet të planifikojë paraprakisht veprimtaritë që do të kryejnë nxënësit. Gjatë aplikimit të kësaj metode, mësuesja përqëndrohet në zhvendosjen e njëkohëshme të nxënësve nga njëra veprimtari në tjetrën, duke përcaktuar modalitetin më të përshtatshëm dhe kohën që do t'u duhet nxënësve për realizimin e secilës veprimtari. Për realizimin me sukses të një ore mësimore të ardhur në këtë format, mësuese Etra duhet të udhëzojë nxënësit mbi çdo veprimtari, duke respektuar kohëzgjatjen e secilës.

Për të ndihmuar procesin, mësuese Etra e sheh me shumë vlerë përgatitjen e instruksioneve dhe ndarjen e tyre me nxënësit para se ata të vijnë në klasë. Pjesë e udhëzimeve paraprake janë edhe orientimet mbi gjetjen e informacionit online. **Një tjetër aspekt i rëndësishëm është edhe përzgjedhja me kujdes e veprimtarive që do të trajtohen online dhe e atyre në formë tradicionale ballë për ballë.** Është e nevojshme që kalimi nga njëra veprimtari në tjetrën të vijë në mënyrë graduale dhe të rrjedhshme, që nxënësit të mos shpërqëndrohen nga larmia e veprimtarive.



Realizimi i mësimit të kombinuar

Veprimtaria 1: Aktivizimi i njohurive



Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Para se nxënësit të vijnë në ambientet e klasës, mesuese Etra ka dërguar skaletën e orës së mësimit me veprimtaritë që nxënësit do të realizojnë në orën pasardhëse. Nxënësit, duke ndjekur instruksionet e dërguara, ulen në stacionin e tyre të punës. Aktiviteti i parë ka të bëjë me aktivizimin e njohurive të cilën mesuese Etra ka menduar ta sjellë në formën e pyetje-përgjigjeve, duke nxitur angazhimin e nxënësve dhe duke shkathësuar komunikimin.



Veprimtaria 2: Ndjekja e një videoje

Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Në aktivitetin e radhës, nxënësve u jepet një minutazh i caktuar për të parë një video individualisht, duke u kërkuar të identifikojnë në tekstin e videos foljet dhe kohën e tyre. Nxënësit shohin videon sipas ritmit të tyre: disa mund t'i rikthehen 2-3, herë ndërsa të tjerë preferojnë të bëjnë pauza dhe të mbajnë shënime. Kjo veprimtari, e sjellë në një formë më interaktive, rrit motivimin dhe angazhimin e nxënësve.

Veprimtaria 3: Diskutim



Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Nxënësve, pasi janë njohur me përmbajtjen e videos, u jepet mundësia të diskutojnë me njëri-tjetrin, duke iu përgjigjur pyetjeve të ndryshme të shtruara nga mësuesja. Kështu ata mësojnë mes tyre dhe plotësojnë njohuritë e njëri-tjetrit, ndërkohë që mësuesja luan rolin e moderatores së diskutimit. Në këtë mënyrë, mësuesja vlerëson njohuritë e nxënësve dhe bën ndërhyrjet e saj në ato konceptet më të rëndësishme.



Veprimtaria 4: Ushtrim

Modaliteti: Ballë për ballë

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Për të përforcuar aftësitë në leximin dhe të kuptuarit e gjuhës angleze, mësuese Etra i vendos nxënësit të punonjë me një tekst dhe të nënvizojnë foljet e një kohe të caktuar. Ky aktivitet shoqërohet nga një ushtrim me gojë, ku nxënësit u përgjigjen pyetjeve të ndryshme.

Veprimtaria 6: Ushtrime



Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 15'

Mënyra e zhvillimit: Pasi mësuesja ka realizuar ndarjen e nxënësve në grupe, i udhëzon ata për veprimtarinë e radhës, atë të ushtrimeve online. Falë udhëzimeve të dërguara online, nxënësit mund të aksesojnë faqet e internetin ku gjenden ushtrimet. Të ndarë në grupe, ato përfitojnë nga njohuritë e njëri-tjetrit. Nxënësit matin progresin e tyre, ndërgjegjësohen mbi boshllëqet, si dhe kuptojnë se ku duhet t'i fokusojnë përpjekjet për përmirësim. Paralelisht mësuesja mat nivelin e përfitimit të njohurive. Nëpërmjet larmisë së ushtrimeve, të gjithë nxënësit angazhohen në orën e mësimin në gjuhën e huaj nëpërmjet leximit, reflektimit, komunikimit dhe dëgjimit. Njëkohësisht nxënësit përmirësojnë aftësitë e tyre digjitale.



Një orë përsëritjeje jo si të tjerat: integrimi i modalitetit online në klasë

Përdorimi i teknologjisë së informacionit në të gjitha fushat e jetës dhe ndërveprimi online ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e produktivitetit dhe menaxhimit më mirë të kohës së gjithsecilit. **Duke marrë në konsideratë faktin se modaliteti online është pjesë integrale e përditshmërisë së brezave të rinj, përdorimi i tij edhe gjatë procesit mësimor përqafohet shpejtë dhe rrit motivimin.**

Ora e përsëritjes konsiderohet sfiduese për mësuesit në përpjekje për të rifreskuar dhe konsoliduar më tej një pjesë të konsiderueshme të informacionit të dhënë më parë. **Falë kalimit të një pjese të veprimtarive në modalitetin online, koha shfrytëzohet në mënyrë optimale, duke krijuar hapësirë për realizimin e një numri më të madh veprimtarish dhe ndërveprim më të lartë.**

Parë nga këndvështrimi i një nxënësi, ai nuk qëndron pasiv, përfshihet në aktivitete të ndryshme, zhvillon aftësinë e tij për të ndërvepruar dhe punuar online, duke e përgatitur kështu edhe për tregun e punës.



Mësime të nxjerra dhe këshilla

1

Modeli i rotacionit sipas stacioneve i aplikuar në klasë gjatë orës së përsëritjes ndihmon në menaxhimin e mirë të kohës dhe rrit efikasitetin e orës së mësimit duke mundësuar zhvillimin e veprimtarive të larmishme. Sidoqoftë, në fokus të planifikimit të veprimtarive duhet të jetë realizimi i suksesshëm i tyre brenda harkut të caktuar kohor dhe jo rritja e sforcuar e numrit të tyre.

2

Koha e shpenzuar në dizinjimin për herë të parë të kësaj ore kërkon angazhim të konsiderueshëm, por implementimi rezulton i thjeshtë nëse i paraprihet me dizejnimin e detajuar të veprimtarive, modalitetit dhe kohës kushtuar secilës. Një qasje e tillë ndihmon në një projektim më të mirë të të gjitha veprimtarive (stacioneve) që do të realizohen në klasë.

3

Kombinimi i veprimtarive ballë për ballë me ato online, si dhe i punës individuale me atë në grup, krijon dinamika në klasë edhe gjatë orës së përsëritjes, e cila, në më të shumtën e rasteve, realizohet në mënyrë të njëtrajtshme nga mësuesit. Falë aplikimit të një formati më të personalizuar të orës së mësimit, duke iu përshtatur më mirë tipologjive të ndryshme të nënësve, shkalla e aktivizimit rritet dhe nxënësit përfitojnë më shumë nga njëri-tjetri.



ROTACIONI SIPAS STACIONEVE

Një orë mësimore ndryshe në lëndën e matematikës

Ersuela Spari



Drejtimi: Elektroteknikë

Lënda: Matematikë

Tema: Kongruenca dhe ngjashmëria

Të mbash nxënësit aktivë gjatë orës së matematikës është një ndër sfidat kryesore me të cilat mësuesit e kësaj lënde ndeshen. Kjo lëndë perceptohet si evështirë nga ana e nxënësve dhe besimi i tyre në aftësinë për të nxënë është i ulët. Si rrjedhojë, edhe angazhimi i tyre është i kufizuar. Një orë tradicionale, ku të gjitha veprimtaritë drejtohen nga mësuesi dhe nxënësi qëndron pasiv, nuk krijon hapësirë për ta bërë lëndën e matematikës tërheqëse dhe nuk arrin të nxitë imagjinatën e tyre. Me dëshirën për të sjellë një orë mësimi ndryshe, Ersuela Spari, mësuese e lëndës së matematikës në shkollën “Gjergj Canco”, është munduar të integrojë elemente të ndryshme angazhuese dhe ndërvepruese për t’i pozicionuar nxënësit e saj në qendër të procesit mësimor. Falë pjesëmarrjes në trajnimin “Mësimi i kombinuar në praktikë”, mësuese Ersuela ka përvetësuar mënyrën e aplikimit të modeleve të ndryshme të mëimit të kombinuar. Elemente të veçanta, të përdorura më

parë në mënyrë sporadike, integrohen tashmë të strukturuar në përputhje me modelin që ajo dëshiron të aplikojë gjatë një ore mësimore.

Për të trajtuar temën “Kongruenca dhe ngjashmëria”, mësuese Ersuela ka përzgjedhur të aplikojë një ndër modelet e mëimit të kombinuar me rotacion, atë të rotacionit sipas stacioneve. Arsyeja e përzgjedhjes së këtij modeli qëndron në faktin se, gjatë orës mësimore, nxënësve u ofrohet një shumëllojshmëri veprimtarish që nxitin ndërtimin e njohurive dhe angazhimin e vazhdueshëm. Ora planifikohet në formë të tillë që nxënësit të zhvendosen të gjithë së bashku nga një veprimtari (stacion) në tjetrën, duke alternuar modalitetin ballë për ballë me atë online. Në këtë mënyrë, nxënësit mund të kryejnë hulumtime online rreth një teme, të bashkëpunojnë në grup për zgjidhjen e një problemi, si dhe të përfshihen në diskutime duke ndërvepruar me mësuesen dhe njëri-tjetrin.

Planifikimi i orës mësimore

Dizenjimi i një klase sipas modelit të rotacionit sipas stacioneve kërkon vëmendje të veçantë në përcaktimin e llojeve të veprimtarive dhe në mënyrën e ndërthurjes së tyre, për t'iu përgjigjur jo vetëm rezultateve të të nxënësve, por edhe tipologjive dhe niveleve të ndryshme të nxënësve, si dhe aftësive digjitale të tyre.

Këto detaje e orientojnë mësuesin edhe në përcaktimin e harkut kohor që do t'i kushtohet secilës veprimtari, në formë tradicionale apo online. Çdo veprimtari duhet të kenë në fokus ndërtimin e njohurive dhe aftësive nga ana e vetë nxënësve, në mënyrë intuitive dhe konceptuale. Për këtë arsye, mësuese Ersuela përfshin si veprimtari hulumtimin online të realizuar në mënyrë individuale. Nga ana tjetër, rëndësi të veçantë mësuesja u jep edhe veprimtarive ballë për ballë, të cilat i mbështet në forma aktive të të nxënësve, ku nxënësit dhe mësuesi janë në ndërveprim të vazhdueshëm, duke i shtuar vlerë procesit mësimor.



Realizimi i mësimit të kombinuar

Veprimtaria 1: Aktivizim i njohurive ekzistuese



Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Faza e parë e orës mësimore – stacioni i parë në modelin e aplikuar - nis me aktivizimin e njohurive të fituara më parë, nëpërmjet formatit klasik pyetje-përgjigje, me qëllim rifreskimin e këtyre njohurive dhe lidhjen e tyre me informacionin e ri që do të merret në vijim.



Veprimtaria 2: Dhënie udhëzimesh mbi hulumtimin online

Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Ora e mësimit vijon me dhënien e udhëzimeve nga mësuesja për veprimtarinë e radhës, e cila konsiston në realizimin e një hulumtimi simultan online mbi konceptet e reja. Në këtë stacion të dytë, mësuesja i prezanton nxënësit me konceptet kyçe të temës së re dhe i fton të kërkojnë dhe të përzgjedhin online nga një përkufizim për secilin koncept.

Veprimtaria 3: Hulumtim online mbi konceptet kyçe të temës së re



Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 15'

Mënyra e zhvillimit: Të gjithë nxënësit realizojnë një hulumtim online në kompjuterat e disponuar, bazuar në fjalët kyçe orientuese të dhëna nga mësuesja. Secili nxënës përcakton vetë se si do ta shfrytëzojë minutazhin në dispozicion dhe në ç'mënyrë do të punojë, duke përzgjedhur motorin e kërkimit, websit-et dhe përkufizimet që i duken më të përshtatshme. Procesi i ndërtimit të njohurive të reja nis, kështu, nga vetë nxënësi.



Veprimtaria 4: Diskutim: thellim në njohuritë e reja

Modaliteti: Tradicional ballë për ballë

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Pas hulumtimit online, kalohet në realizimin e një diskutimi ballë për ballë mes mësueses dhe nxënësve, si pjesë e procesit të konsolidimit të njohurive të reja. Të vendosur në qendër të veprimtarisë, nxënësit prezantojnë përmbledhtazi produktin e punës kërkimore – përkufizimet e gjetura mbi konceptet thelbësore – dhe diskutojnë me njëri-tjetrin duke plotësuar përgjigjet. Mësuesja ndërhyr duke rimarrë përkufizimet dhe duke i saktësuar ato, si dhe nxit nxënësit të reflektojnë mbi lidhjen e koncepteve të reja me ato të fituara më parë.

Veprimtaria 5: Test



Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Për këtë stacion të fundit të orës së mësimit, mësuesja ka hartuar paraprakisht një test për matjen e nivelit të përthithjes së njohurive të reja. Testi, i përbërë nga pyetje me alternativa dhe pyetje të hapura të shkurtra, është ngarkuar në Google Classroom. Të gjithë nxënësit marrin pjesë njëkohësisht në test nëpërmjet platformës. Mësuesja njofton nxënësit se do të njihen me rezultatet online.




Një orë mësimore ndërvepruese: përdorimi i teknologjisë në lëndët ekzakte

Të aplikosh mësimin e kombinuar në lëndë ekzakte nuk është aspak e thjeshtë, veçanërisht kur bëhet fjalë për matematikën. Tradicionalisht, lënda e matematikës është konsideruar dhe zhvilluar mbi bazën e shpjegimit klasik, mbështetur në zgjidhje ushtrimesh apo problemash në “dërrasën e zezë”, të cilat në vijim të orës realizohen nga nxënësit. Në këtë mënyrë, nxënësit vihen në pozita riprodhimi mekanik të njohurive që mësuesi përcjell, ndërkohë që hapësira për të zbuluar dhe ndërtuar vetë njohuritë, për të ndërvepruar me të tjerët dhe për të zhvilluar njëkohësisht aftësi të tjera përtej atyre specifike të lëndës, është e kufizuar.

Mësuese Ersuela ka kuptuar se ndërthurja e qasjes tradicionale ballë për ballë me veprimtari online mund të riformësojë orët mësimore në lëndën e matematikës, duke nxitur motivimin dhe angazhimin e nxënësve dhe duke e bërë lëndën më interesante për ta.

Vendosja e nxënësve në pozita pune, ku në shembullin e mësuese Ersuelës ata realizojnë procesin e ndërtimit të njohurive të reja fillimisht në mënyrë individuale nëpërmjet hulumtimit online, dhe kryerja e disa aktiviteteve në modalitetin online, ndihmon nxënësit të kuptojnë se për të kërkuar informacion apo për të thelluar njohuritë ata mund t’u qasen burimeve të ndryshme të informacionit, të cilat vijnë në formate të ndryshme, duke iu përshtatur kështu preferencave të tyre.



Mësime të nxjerra dhe këshilla

1

Mësimi i kombinuar, kur bazohet në ndërthurje të mirëmenduar të metodave dhe veprimtarive, rezulton i suksesshëm edhe në lëndë që shpesh perceptohen si të realizueshme vetëm në formatin tradicional. Për të garantuar efikasitetin e tij, nevojitet një planifikim i kujdesshëm dhe i detajuar i veprimtarive mësimore, duke gjykuar se cili modalitet do të ishte më i përshtatshëm për secilën veprimtari.

2


Dizenjimi për herë të parë i orës me anë të rotacionit sipas stacioneve kërkon kohë dhe angazhim të konsiderueshëm në planifikimin e veprimtarive dhe në hartimin e materialeve mbështetëse. Procesi lehtësohet nëse puna nis me një numër më të reduktuar veprimtarish, për t'u dhënë mundësi nxënësve dhe mësuesve të përshtaten gradualisht me këtë qasje të re.

3

Aplikimi i mësimi të kombinuar me rotacion sipas stacioneve kërkon informim paraprak të nxënësve për t'u familjarizuar me një mënyrë të re të ndërtimit të orës së mësimi dhe të menaxhimit të kohës. Para se nxënësit të vijnë në klasë, këshillohet dërgimi i një skalette të orës mësimore, ku të evidentohen stacionet e punës dhe renditja e tyre.

4

Mundësia që u jepet në përzgjedhjen e mënyrës së realizimit të një veprimtarie, si në rastin e hulumtimit online, mund të krijojë vështirësi në menaxhimin e klasës. Sidoqoftë, përfitimet si angazhimi i nxënësve apo përmirësimi i aftësive hulumtuese janë mbizotëruese, ndërkohë që sfida në menaxhim zbehet me fitimin e përvojës.



ROTACIONI NË LABORATOR

Aplikimi i njohurive duke u argëtuar

Eni Xhogu

Drejtimi: TIK

Lënda: Dizenjim grafik

Tema: Ngjyrat në dizenjimin grafik



Në dekadat e fundit, ndryshimet e mëdha në teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit kanë nxitur mësimdhënësit të testojnë integrimin e teknologjisë edhe në procesin mësimor, për të parë impaktin që mund të ketë në edukimin e brezave të rinj.

Padyshim që brezi i gjeneratës Z, i lindur në kohën e “botës digjitale”, e përqafton integrimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe është më aktiv gjatë përdorimit të saj. Bota virtuale nuk merr parasysh kufijtë e klasave apo muret e shkollave, ashtu sikurse nuk merr parasysh as kufijtë kohorë. Nxënësit mund të sjellin përvojat dhe jetët e tyre digjitale në shkollë dhe është detyra e mësimdhënësve që ta integrojnë këtë realitet të ri në sistemin tonë arsimor.

Nga dëshira për të marrë sa më shumë nga botëkuptimi i nxënësve dhe për t'i aftësuar ata në mënyrë aktive, Eni Xhogu, mësuese në shkollën “Gjergj Canco”

Tiranë, aplikon mësimin e kombinuar sipas modelit të rotacionit në laborator në tema të caktuara të lëndës Dizenjim grafik. Gjatë aplikimit të këtij modeli, mësuese Eni së bashku me nxënësit e saj kombinojnë veprimtari të ndryshme ballë për ballë me ato online, duke alternuar gjithashtu edhe stacionet e tyre, në klasë dhe në laborator.

Gjatë këtij procesi, nxënësit integrojnë përdorimin e aplikacioneve dhe platformave të ndryshme të ndërtuara posaçërisht për mësimdhënie ose që mund të shfrytëzohen edhe në kontekstin mësimor. Në këtë mënyrë, nxënësit motivohen dhe angazhohen më shumë në procesin e të nxënësve. Ata të ndihen më të relaksuar gjatë orës mësimore dhe ndërveprojnë më shumë si me mësuesen, ashtu edhe me njëritjetrin, duke lënë hapësirë për shfaqjen e kreativitetit të tyre dhe shprehjen e mendimit ndryshe.

Planifikimi i orës mësimore

Për realizimin e orës me rotacion në laborator, mësuese Eni i kushton rëndësi të veçantë përzgjedhjes së veprimtarive që do të realizohen në klasë dhe atyre në laborator, për shfytëzimin në mënyrë eficiente të kohës, si dhe të mundësive që ofrojnë dy mjediset. Një minutazh i caktuar përlllogaritet edhe për zhvendosjen e nxënësve nga stacioni në klasë në atë në laborator.

Sipas mësuese Enit, një orë mësimore e suksesshme nëpërmjet rotacionit në laborator realizohet duke:

- përzgjedhur veprimtaritë dhe mënyrën se si do të zhvillohen ato në secilin mjedis;
- përcaktuar kohëzgjatjen e secilës veprimtari;
- qenë kreativ në mënyrën se si do të përdoren pajisjet e laboratorit;
- përgatitur materiale mbështetëse, të cilat përdoren nga nxënësit gjatë kohës që do të jenë online, ose nga vetë mësuesi përgjatë orës mësimore;
- identifikuar platformat dhe/ose aplikacionet të cilat mund të vijnë në ndihmë gjatë modalitetit online, për një orë mësimore sa më interaktive.



Realizimi i mësimit të kombinuar

Veprimtaria 1: Aktivizimi i njohurive



Modaliteti: Ballë për ballë

Vendndodhja: Klasë

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Mësuese Eni e nis orën e mësimit në klasë me aktivizimin e njohurive duke shtruar disa pyetje. Nxënësit angazhohen duke dhënë përgjigjet e tyre dhe ndihmojnë në krijimin e një harte mendore, me në qendër konceptin kyç të njohurive të fituara më parë. Gjithashtu, mësuesja projektin në klasë imazhe dhe logo të ndryshme dhe nxënësit i interpretojnë ato. Kështu, mësuesja rrit angazhimin e nxënësve dhe orienton diskutimin drejt temës së re.



Veprimtaria 2: Përcjellja e njohurive të reja

Modaliteti: Ballë për ballë

Vendndodhja: Laborator

Kohëzgjatja: 15'

Mënyra e zhvillimit: Nxënësit ndryshojnë stacionin e tyre, duke lëvizur në laboratorin e informatikës. Aty mësuesja bën transferimin e njohurive të reja, duke projektuar prezantimin e përgatitur prej saj në platformën MësoVET, i cili mund të aksesohet nga nxënësit edhe pas mbarimit të orës. Ndërkohë që nxënësit thithin njohuritë e reja, ata angazhohen në diskutim duke ndërvepruar me njëri-tjetrin dhe mësuesen. Në këtë mënyrë, nxënësit nuk qëndrojnë pasivë dhe ora bëhet më interaktive.





Veprimtaria 3: Detyrë

Modaliteti: Ballë për ballë + Online

Vendndodhja: Laborator

Kohëzgjatja: 15'

Mënyra e zhvillimit: Për të vendosur në praktikë njohuritë e marra, mësuesja u kërkon nxënësve të dizenojnë në programin Photoshop një logo me fokus barazinë gjinore, sociale ose ekonomike, duke përdorur ngjyra të cilat lidhen me këto koncepte. Nxënësit janë të lirë të përzgjedhin tematikën dhe ta realizojnë detyrën sipas dëshirës së tyre, duke zhvilluar edhe sensin e kreativitetit. Pasi përgatitet, detyra vendoset në Padlet-in e krijuar paraprakisht nga mësuesja.

Veprimtaria 4: Minikonkurs nëpërmjet sondazhit



Modaliteti: Online

Vendndodhja: Laborator

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Pas përfundimit të ushtrimit nga të gjithë nxënësit, mësuesja realizon një minikonkursi mbi bazën e detyrave të vendosura në Padlet, ku nxënësit vlerësojnë logon më të mirë. Vlerësimi realizohet nëpërmjet një “reje fjale” (word cloud) në Mentimeter, ku nxënësi mjafton të shkruajë numrin që mbart logoja e tij e preferuar dhe, në kohë reale, sheh të projektuar numrin më të votuar. Pas mbarimit të orës, nxënësve u jepet mundësia të vazhdojnë të përmirësojnë detyrën e tyre dhe ta rihedhin në Padlet.

Të mësuarit duke u argëtuar: integrimi i mjeteve ndërvepruese

Ekzistojnë një numër i madh mjetesh digjitale ndërvepruese që u vijnë në ndihmë mësuesve dhe nxënësve, si në klasë, laborator apo jashtë mjedisit shkollor. Një ndër to është Padlet, një “mur” apo tablo digjitale, ku përdoruesit mund të postojnë tekst, imazhe, linqe, video apo dokumente të tjera dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Mësuese Eni e shfrytëzon këtë hapësirë interaktive edhe në formën e një “depoje” detyrash të realizuara në klasë ose shtëpi, ku të gjithë nxënësit ngarkojnë detyrën e tyre dhe njëkohësisht njihen me punën e shokëve. Krahas dhënies së komenteve dhe vlerësimeve gjatë orës së mësimit, si nga ana e mësueses, ashtu edhe mes nxënësve me njëri-tjetrin, prania e detyrave në të njëjtën hapësirë në padlet u jep mundësi nxënësve të ndërveprojnë edhe përtej orës së mësimit. Falë opsioneve që ky aplikacion ofron, nxënësit mund të komentojnë apo të japin sugjerime mbi punimet e shokëve.

E përdorur në kuadër të rotacionit në laborator, por që ka vend për përdorim edhe në format e tjera të mësimit të kombinuar, integrimi i padlet mundëson një proces të nxëni që nuk mbaron me mbylljen e orës së mësimit, por i mban të angazhuar nxënësit edhe jashtë mjedisëve të shkollës.

Mjete të tjera ndërvepruese të integruara në mësimdhënie janë edhe Mentimeter, Slido, Kahoot, nëpërmjet të cilëve nxënësit nxënë duke u argëtuar. **Një qasje e tillë rrit mundësitë për pjesëmarrje më të lartë nga ana e nxënësve në procesin mësimor. Ata janë më të hapur të ndajnë mendimet e tyre pa u ndjerë të gjykuar.** Përdorimi i mjeteve të tilla ndërvepruese është parë nga mësuesit si një formë shumë efektive e përvetësimit të informacionit të ri, ndërkohë që procesi i të nxënit vjen në formën e një loje.



Mësime të nxjerra dhe këshilla

1

Fillimisht riorganizimi i veprimtarive dhe përgatitja e materialeve mësimore sipas këtij modeli mësimdhënjeje kërkon kohë dhe kreativitet. Mësuesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm për volumin disi më të madh të punës që krijon aplikimi i modeleve të ndryshme të mësimit të kombinuar, por njëkohësisht duhet të besojë në lehtësimin e punës së tij pas krijimit të bazës së planeve dhe instrumenteve të cilat do t'i shërbejnë për replikim veprimtarish dhe orësh mësimi.

2

Shoqërimi i modelit të rotacionit në laborator me zhvendosje fizike nga një mjedis i shkollës në tjetrin merr kohë dhe mund të sjellë edhe shpërqëndrim të nxënësve. Çdo mësues, gjatë planifikimit, duhet të marrë në konsideratë minutazhin e ndryshimit të ambienteve, si dhe të parapërgatitë mjediset për një menaxhim efektiv të klasës.

3

Pavarësisht tematikës apo modelit të aplikuar të mësimdhënies, integrimi i qasjes së bazuar në elemente motivuese dhe argëtuese për nxënësit, të tilla si zhvillimi i minikonkursit online mbi bazën e detyrave dhe votimit nëpërmjet një sondazhi, rrit efektivitetin e orës së mësimit dhe krijon një eksperiencë dinamike dhe më të pasur të nxëni. Mësuesit duhet të guxojnë të aplikojnë metoda të tilla, që përkthehen në angazhim më të lartë dhe interaktivitet të shtuar.



ROTACIONI INDIVIDUAL

Një orë mësimore e moderuar nga vetë nxënësi

Blerta Shkreta

Drejtimi: Ekonomi - Biznes

Lënda: Gjuhë angleze

Tema: Përdorimi i gjerë i internetit



Vitet e fundit, mësimdhënia në arsimin profesional është orientuar drejt aplikimit të modeleve të reja me nxënësin në qendër, të cilit i krijohen hapësirat dhe kushtet e përshtatshme për ndërveprim, përzgjedhje dhe punë të pavarur, në formën, vendin dhe kohën e dëshiruar. Në ndihmë të këtyre qasjeve të reja vijnë platformat digjitale për mësimdhënie, siç është MësoVET.

Krahas mbështetjes së veprimtarive të ndryshme gjatë orës mësimore, platforma të tilla shërbejnë edhe për të nxitur punën e pavarur të nxënësve në një mjedis virtual gjithëpërfshirës, angazhues dhe tërheqës, si dhe si një “depo” e pasur materialesh mësimore interaktive, portofolësh elektronike apo detyrash.

Duke parë funksionet e ndryshme

që platforma MësoVET ofron, Blerta Shkreta, mësuese e gjuhës angleze në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë e përdor gjatë aplikimit të modeleve të ndryshme të mësimit të kombinuar.

Me interes të veçantë janë orët në të cilat mësuese Blerta aplikon modelin e rotacionit individual, ku nxënësit kanë kontroll mbi rendin, mënyrën dhe kohën e zhvillimit të veprimtarive, ndërkohë që mësuesja orienton dhe ndihmon nxënësit sipas nevojave të tyre. Duke aplikuar këtë model, mësuese Blerta dëshiron që nxënësit të aftësohen në personalizimin e orës së mësimit dhe të mënyrës së të nxënit në tërësi, duke e përshtatur sipas aftësive, preferencave dhe ritmit të tyre, herë në modalitetin online dhe herë në formatin tradicional të të nxënit.

Planifikimi i orës mësimore

Në planifikimin e një orë mësimore me rotacion individual, mësuese Blerta, ashtu si çdo mësues që do të dëshironte ta aplikonte këtë model, duhet të vendosë veten në rolin e lehtësuesit të procesit mësimor, duke lënë të gjitha aktivitetet të udhëhiqen nga nxënësit. Për këtë arsye, **mësuesja planifikon një larmiveprimtarish, të cilat u përgjigjen tipologjive të ndryshme të nxënësve dhe njëkohësisht arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënësve.** Veprimtaritë mbështeten nga materiale mësimore të cilat nxënësit mund t'i aksesojnë online apo në version të printuar. Nga ana tjetër, **nxënësit, të cilët kanë autonomi gjatë procesit të të nxënësve, kanë nevojë të marrin instruksione të sakta për t'u orientuar përgjatë orës mësimore.** Për këtë arsye, para se nxënësit të shkojnë në klasë, mësuese Blerta ka dërguar skaletën e orës së mësimit me veprimtaritë që do të realizojnë orën e ardhshme. Me aplikimin e mësimit të kombinuar sipas modelit të rotacionit individual, ku çdo nxënës përcakton vetë kohën që shpenzon në secilën veprimtari, mësueses i lindi ideja t'i aftësonte nxënësit, në mënyrë indirekte, edhe në menaxhimin e kohës. Për këtë arsye, ajo u ka kërkuar atyre të planifikojnë minutazhin që ata mendojnë se do t'i marrë secila veprimtari dhe, gjatë kryerjes së secilës, të mbajnë shënim edhe kohën e shpenzuar.



Realizimi i mësimit të kombinuar

Veprimtaria 1: Aktivizimi i njohurive



Modaliteti: Ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Nxënësit, të orientuar nga instruksionet e dërguara nga mësuesja rreth aktiviteteve që do të realizojnë gjatë orës mësimore, ulen në vendin e tyre të punës. Aktiviteti i parë ka të bëjë me aktivizimin e njohurive, të cilën mësuese Blerta ka menduar ta sjellë në formën e pyetje-përgjigjeve, duke nxitur angazhimin e nxënësve dhe duke shkathtësuar komunikimin.



Veprimtaria 2: Lexim ose dëgjim i audios

Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 10'

Mënyra e zhvillimit: Për realizimin e veprimtarisë së dytë, mësuesja fton nxënësit të fillojnë punën individuale duke ndjekur udhëzimet e dërguara paraprakisht prej saj. Nxënësit kanë zgjedhjen mes leximit të një teksti në libër, apo dëgjimit të tij në versionin audio, i cili është ngarkuar në platformën MësoVET. Nxënësit, pasi kanë përzgjedhur stacionin e tyre, fillojnë punën. Ata kanë mundësinë të ndjekin ritmin e tyre gjatë realizimit të veprimtarisë. Në fund të saj mbajnë shënim minutazhin që ata në të vërtetë i dedikuan.

Veprimtaria 3: Diskutim



Modaliteti: Ballë për ballë

Kohëzgjatja: 5'

Mënyra e zhvillimit: Nxënësit angazhohen në veprimtarinë (stacionin) e radhës, e cila vjen në formën e një diskutimi. Mësuesja hap një temë në lidhje me materialin e lexuar ose dëgjuar nga nxënësit për të matur kuptueshmërinë e koncepteve kyçe të trajtuara në të. Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe plotësojnë njëri-tjetrin kur e shohin të nevojshme.



Veprimtaria 4: Nxjerrja e fjalëve të reja

Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 5’

Mënyra e zhvillimit: Kur mësuesja e sheh të arrirë qëllimin e diskutimit, fton nxënësit të vazhdojnë me veprimtarinë e radhës. Nxënësit, të orientuar nga instruksionet e dërguara online, “zhvendosen” në stacionin tjetër. Gjatë kësaj veprimtarie, secili nxënës, sipas ritmit të tij, rilexon ose dëgjon materialin duke patur në fokus nxjerrjen e fjalëve të reja.

Veprimtaria 5: Përkthimi i fjalëve



Modaliteti: Ballë për ballë ose online

Kohëzgjatja: 10’

Mënyra e zhvillimit: Në stacionin e radhës, krahas kohës, nxënësit kanë mundësinë të përzgjedhin në mënyrë individuale se si do ta realizojnë veprimtarinë. Ata mund të përkthejnë fjalët e reja: (i) me ndihmën e mësueses, ose (ii) nga interneti. Në fund të këtij aktiviteti, mësuesja pyet disa prej nxënësve nëse koha e parashikuar për secilën veprimtari përkoi me minutazhin që i dedikuan në të vërtetë.



Veprimtaria 6: Ushtrim

Modaliteti: Online

Kohëzgjatja: 10’

Mënyra e zhvillimit: Nxënësit konsultojnë skaletën për të parë stacionin e radhës, i cili vjen në formën e një ushtrimi. Mësuesja u ka kërkuar nxënësve të ndërtojnë nga një fjali apo të shkruajnë një paragraf me fjalët e reja. Pas përfundimit, nxënësit ngarkojnë detyrën e tyre në platformën MësoVET. Në këtë mënyrë, mësuesja bën vlerësimin online dhe jep feedback-un për secilën detyrë. Nxënësit mund të konsultohen me feedback-un e dhënë nga mësuesja në vendin dhe kohën e dëshiruar.

Platforma MësoVET:

një instrument për ngarkimin e detyrës dhe vlerësimin e nxënësve

Platforma digjitale MësoVET, e bazuar në Moodle, është zhvilluar dhe përshtatur nga projekti S4J në mbështetje të e-Mësimin. Përpos shumë avantazhesh të lartpërmendura që sjell integrimi i kësaj platforme në procesin mësimor, mësuese Blerta e shfrytëzon atë si një instrument për ngarkimin e detyrave dhe vlerësimin e nxënësve. Duke zbatuar një praktikë të tillë, nga njëra anë, nxënësit krijojnë depon e detyrave të realizuara prej tyre dhe nga ana tjetër, mësuesja bën vlerësimin online dhe dokumenton procesin.

Gjatë vlerësimin, mësuesja ka edhe mundësinë të shtojë feedback-un e saj të personalizuar për secilin nxënës. Në këtë mënyrë, nxënësi mund të konsultohet online në çdo kohë me vlerësimin dhe të ndjekë ecurinë e tij përgjatë gjithë vitit shkollor.

Dorëzimi i detyrave online u krijon hapësirë nxënësve t'i realizojnë ato në formatin e dëshiruar, duke nxitur kreativitetin e tyre dhe zhvillimin e aftësive kompjuterike.

Nxënësit mund ta sjellin detyrën në formën e një prezantimi në PowerPoint ose Prezi, mund ta

punojnë në Microsoft Word, apo, për nxënës me aftësi digjitale më të avancuara, mund ta përgatitin edhe në formën e një videoje. Në rastet kur në ambientin e shtëpisë mungon infrastruktura digjitale e nevojshme për përdorimin e këtyre programeve apo aplikacioneve, detyra mund të punohet në fletore dhe të ngarkohet si fotografi nga aparati celular.



Mësime të nxjerra dhe këshilla

1

Rotacioni individual, si një ndër modelet ku nxënësit i jepet më tepër kontroll dhe pavarësi në raport me modelet e tjera të mësimit të kombinuar, kërkon informim paraprak të nxënësve mbi mënyrën se si do të realizohet. Veçanërisht në hapat e parë të aplikimit të tij, sugjerohet që mësuesi të ndajë me nxënësit një skaletë të veprimtarive të parashikuara, së bashkë me disa detaje të secilës veprimtari, në mënyrë që nxënësit ta kenë më të thjeshtë për vendosin mbi rendin dhe mënyrën e zhvillimit të tyre.

2

Krijimi i hapësirave për përzgjedhjen e mënyrës së realizimit të veprimtarive mësimore nga ana e vetë nxënësve mund të krijojë fillimisht pasiguri dhe skepticizëm te mësuesi për shkak të aplikimit të një qasjeje që ndryshon shumë nga ajo e zakonshme, ku mësuesi luan rolin e lehtësuesit. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, menaxhimi i veprimtarive dhe i klasës në tërësi bëhet më i thjeshtë dhe mësuesi e ka më të thjeshtë konfigurimin dhe luajtjen e rolit të tij, si dhe raportimin me nxënësit.

3

Modeli i rotacionit individual kërkon kreativitet nga ana e mësuesit. Çdo mësues duhet t'u ofrojë nxënësve veprimtari që mundësojnë arritjen e rezultateve të të nxënësve pavarësisht aftësive individuale, ritmit të punës apo mënyrës së zhvillimit të saj. Aftësimi i mësuesve në përdorimin e instrumenteve vizualizuese, mediave të ndryshme, aplikacioneve apo platformave online krijon mundësi të shumta për ta zbatuar me sukses këtë model.





MËSIMI I KOMBINUAR

Një zgjidhje efektive për të nxënit në arsimin profesional

—
Raste të mira 2022

LE TË MBETEMI NË KONTAKT!

 www.aftesiperpune.al

 [@S4J.Swisscontact](https://www.facebook.com/S4J.Swisscontact)

 [skills_for_jobs](https://www.instagram.com/skills_for_jobs)

 [Skills for Jobs Albania](https://www.linkedin.com/company/skills-for-jobs-albania)

 [Aftësi për Punë S4J](https://www.youtube.com/channel/UC...)

